



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No. 01 / 793	
DAT.DT. 22. 10. 21	
PRISHTINË	

KGJK.nr.283/2021  
Datë: 18 tetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 42 të Rregullores nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nenit 17 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 268-të, të mbajtur më datë 18 tetor 2021, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Ekstraktet e procesverbaleve të takimeve të Komisioneve të Përhershme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe takimet e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave, të transkriptohen vetëm në pjesët e vendosura për çështje me rëndësi të cilat vlerësohen nga kryetarët e komisioneve, respektivisht kryesuesi i asamblesë.
- II. Audio apo video-incizimet e takimeve të Komisioneve dhe Asamblesë të vendosen në CD dhe të ruhen në Arkivin e KGJK-së dhe tek Sekretarët e komisioneve përkatëse.
- III. Të vazhdohet transkriptimi i mbledhjeve të KGJK-së, konform nenit 42 të Rregullores nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Paneleve Hetimore.
- IV. Vendimi hyn në fuqi më 18 tetor 2021.

## A r s y e t i m


Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 18 tetor 2021, shqyrtoi çështjen e transkriptimit të procesverbaleve për takimet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe takimeve të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, KGJK pati parasysh faktin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka filluar punën me një dinamikë dhe se në përfundimin e aktiviteteve dhe prioriteteve të punës në përgjithësi, transkriptimi i procesverbaleve po shkakton vështirësi.

Po ashtu, legjislacioni në fuqi, nuk parasheh transkriptimin e takimeve të komisioneve apo të asamblesë, prandaj, Këshilli, vendosi që të mbetet në diskrecion të kryetarëve të komisioneve përkatësisht kryesuesit të asamblesë, të vlerësoj nevojën e transkriptimit të çështjeve me rëndësi të vendosura apo marrjen e qëndrimeve në komisionet respektivisht në asamble. KGJK, po ashtu vendos që të gjitha takimet të incizohen dhe audio-video incizimet të ruhen në Arkivin e KGJK-së dhe tek sekretarët e komisioneve përkatëse.

Kurse, sa i përket transkriptimit të mbledhjeve të KGJK-së në nenin 42 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, parashihet se Sekretariati ofron mbështetje administrative që të gjitha mbledhjet e Këshillit të incizohen në audio-incizim, transkriptohen dhe të ruhen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu, neni 17 i Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, përcakton se seancat dëgjimore transkriptohen nga audio incizimi, i cili shërben si procesverbal në procedurën dëgjimore, andaj, bazuar në këto që u theksuan si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Komisioneve të Përhershme të KGJK-së;
- Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.